REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT**

**VENDIM**

Nr.17, datë 12.10.2022

**PËR**

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES NR.SERIE 00011, DATË 03.03.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN NR.53, DATË 22.02.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, SUBJEKTIT "GJOKA 2002" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 00011, datë 03.03.2017 miratuar me Vendimin Nr.53, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

   Vendndodhja e pus shpimit me koordinatat (KRGJSH) do të saktësohen:

   Nga: X= 473216; Y= 4617724; Z= 8 m.m.n.d

   **Në : X= 473422; Y= 4617227; Z= 8 m.m.n.d**

- Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=4 l/s
- Prurja mesatare : $Q_{mes}$= 20 l/s

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në shtartin e Lumit Mat

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 00011, datë 03.03.2017 miratuar me Vendimin Nr.53, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat, "leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë teknologjik (larje inertesh)", sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, fshati Gajush, bashkia Lezhë.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR - MAT